



**REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK**

**KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS**  
**NATIONAL COUNCIL FOR THE SURVIVORS OF SEXUAL VIOLENCE DURING THE WAR**  
**NACIONALNI SAVET ZA PREŽIVELE SEKSUALNOG NASILJA TPKOM RATA**

Shtojca 1

Përfundimet dhe rekomandimet e takimit të katërt

1 Korrik 2015, Prishtinë

1. Në takimin e katërt të Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës u prezantuan aktet nënligjore përkatësisht Projekt-rregullorja Nr. XX/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës, si dhe Draft-formularin për aplikim, të përpiluara nga ekipi punues i udhëhequr nga Zyra Ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Presidentit.
2. Projekt-rregullorja përcakton kushtet, kriteret dhe unifikon procedurat për njohjen dhe për verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, si edhe organizimin e punës, funksionimin dhe detyrat e përgjegjësit e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës ashtu siç parashihet me ligj.

3. Anëtarët e Këshillit mirëpritën përpilimin e këtyre dokumenteve dhe rekomanduan që përmbajtja e tyre të jetë sa më e thjeshtë, më e kuptueshme për nga forma dhe përmbajtja.
4. U rekomandua që Qeveria të ndërmarr sa më parë hapat e mëtejshëm ligjor, përkatësisht të miratoi Draft Rregulloren dhe ta parasheh në planin e buxhetit, në mënyrë që të implementohen predispozitat e përcaktuara në të.
5. U rekomandua që procesi i njohjes së statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës dhe përfitimeve të parapara me ligj, të filloi sa më parë dhe u rekomandua që Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës ti ofrohet një trajnim intensivë.
6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u zotua se do të trajtoj me prioritet të drejtat dhe përgjegjësit të cilat rrjedhin nga ligji që trajton këtë kategori si në punësim, aftësim, riaftësim në të gjitha projektet dhe skemat të cilat menaxhohen nga institucionet, për përmirësimin e mirëqenies, statusit por edhe riintegrimin të kësaj kategorie.
7. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi i siguroi anëtarët e Këshillit se hapat e plotësimit të rregullativave dhe planifikimit të masave përkrahese do të vazhdojnë, dhe se shumë shpejt do të themelohet dhe fuqizohet Komisioni Qeveritar për njohjen edhe verifikimin e statusit të personave të dhunuara gjatë luftës.
8. U rekomandua që Ministria e Shëndetësisë të ofrojë trajtim psiko-social dhe shërbime shëndetësor falas për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, duke e përfshirë edhe këtë kategori në ligjin për sigurime shëndetësore. Në këtë drejtim u rekomandua marrja e masave të nevojshme ligjore.
9. U rekomandua që viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës të cilët kanë ndërruar jetë, të bëhen pjesë e ligjit, përfitues të të cilit të jenë familjarët e tyre.
10. U rekomandua që Prokuroria e Shtetit që të ngritë padi ndaj kryerësve të krimin ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

11. Zëvendës Ministri i Drejtësisë z. Lirak Çelaj, njoftoi anëtarët me hapat e ndërmarr në fushën e drejtësisë, pas kërkesës së Presidentes Jahjaga për përpilimin e një strategjie gjithëpërfshirëse nga institucionet e drejtësisë.
12. Ministria e Drejtësisë, në kuadër të Këshillit Kombëtar ka themeluar dhe koordinon grupit punues ndërinstytucional me përfaqësues nga Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor, me përfaqësues të EULEX-it, Zyren e Presidentes si edhe me Organizatat Joqeveritare.
13. Zv. Ministri Çelaj prezantoi predispozitat e përgjithshme të planit strategjik të përpiluar nga grupi punues për të garantuar qasje më të lehtë në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.
14. U rekomandua që koordinimi ndër institucional të vazhdoj dhe më tej për të forcuar qasjen në drejtësi, për të garantuar qasjen e nevojshme shëndetësore, duke vazhduar përpjekjet për fuqizimin ekonomik dhe duke luftuar stigmën, dhe ngritur vetëdijen shoqërore.